

**STATUT/AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK"**

Ne baze te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME  
FORMIMI I SHOQERISE  
NENI 1**

1 . Shoqeria tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" shpk me seli ne adresen Kashar ,Yrshek Godina nr 25, H11 Tirane, formohet nga ortaku themelues:

**Z.AYFER KORKMAZ**, i datelindjes 13.09.1971, lindur ne Yalova , banuese ne Termal /Turqi, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me numer identifikimi personal U30297765 referuar ne vazhdim si Ortaku i Vetem.

E cila me vullnetin e saj te lire dhe te plote dhe ne perputhje me ligjin "PER SHOQERITE TREGTARE", REGJISTRIN TREGTAR si dhe AKTIN E THEMELIMIT ka vendosur te destinoje ne kete sipermarrje kapitalin e tij vendas, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e shoqerise, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

2. Shoqeria e ushtron veprimtarine ne baze te ekonomise se tregut te lire.
3. Shoqeria eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar duke u pajisur me lejen e ushtrimit te te profesionit nga zyra e qendres kombetare te regjistrimit (QKB)te rajonit perkates.
4. Shoqeria tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" shpk fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj prane zyres se qendres kombetre te regjistrimit(QKR).

**FORMA, EMERTIMI  
NENI 2**

1. Shoqeria Tregtare eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar.
2. Emertimi i Shoqerise eshte "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" shpk.
3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare mund te ruhet i njejti emertim, me kusht qe personi juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.
4. Shoqeria zoteron dhe perdor marken, simbolin dhe vulen e saj me emrin "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" ose "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" ose "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK". Keto nuk mund te zoterohen apo perdoren nga pale te tjera si vendas apo te huaj pa miratimin me shkrim te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie.

**SELIA  
NENI 3**

Selia e shoqerise "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" shpk ndodhet ne Tiranë, Kashar ,Yrshek Godina nr 25, H11 Tirane Albania. Shoqeria mund te krijojte filiale, dege e perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ashtu dhe jashte territorit te saj sipas nevojave. Selia mund te ndryshohet/transferohet ne cdo vend tjetër me vendim te Asamblese se Ortakut/eve, i cili ratifikohet nga mbledhja e afert e asamblese se zakonshme. Keto vendime depozitohen ne Regjistrin Tregtar.

**NENI 4**



## **KOHEZGJATJA**

1. Shoqeria tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" shpk do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet duke perfshire edhe edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

## **OBJEKTI**

### **NENI 5**

Shoqeria "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- Kryerjen dhe zhvillimin e te gjitha veprimtarive dhe akteve qe lejon legjislacioni edhe aktet nenligjore ne fuqi, ne fusha te ndryshme te arsimit dhe keshillimit psikologjik , dhe hapje te qendrave arsimore dhe keshilluese ...., etj., si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne territorin Nderkombetar.
- Gjithashtu, ushtrimi i cdo lloj operacioni tjeter legal qe mund te jete e nevojshme per Shoqerine.

### **NENI 6**

Shoqeria Tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" sh.p.k., nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.

Ky kapital depozitohet sipas ligjit. Ne librin e llogarise te Shoqerise krijohet fondi themeltar ku shenohet kapitali i ortakeve.

### **NENI 7**

#### **KAPITALI**

Kapitali themeltar eshte 100.000(njeqindmije) Leke, i ndare ky ne 1 kuota, nga ku 100% e kapitalit i perket **Z.AYFER KORKMAZ**.

### **NENI 8**

Shoqeria ka te drejte te krijojte fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik dhe tregtar.

### **NENI 9**

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante percaktohen nga ortaket sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi cdo operacion financiar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

### **NENI 10**

1. Shoqeria tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" sh.p.k., eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te marre, te perdore, te bleje apo shese dhe te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike, apo kontabiliteti dhe juridike paguhen vetem nga fondet e shoqerise.

### **NENI 11**





1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te ortakeve te hartuara nga ortaket dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me vendim te ortakeve.

#### **NENI 12**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

#### **NENI 13**

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

#### **NENI 14**

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve.

#### **NENI 15**

Zmadhimi i kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me vendimin e ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.

#### **NENI 16**

##### **ORTAKERIA**

Ortaket e shoqerise tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" sh.p.k., gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper te gjitha detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacion e republikes se shqiperise, ne aktin e themelimit dhe ne satutin e shoqerise.

#### **NENI 17**

##### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE.**

1. Te marrin pjese ne mbledhjet e asamblese se ortakeve duke ushtruar te drejten e votes.
2. Te paraqesin pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit.
3. Te informohen mbi pergatitjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel.
4. Te perfitojne nga fitimi i shoqerise.
5. Te kerkojne prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara.

#### **NENI 18**

##### **ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

1. Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i zgjedhur nga Ortaku i Shoqerise. Si Administrator i shoqerise do te zgjidhet **AYFER KORKMAZ**, me nje afat 5 vjecar, e cila perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet. Administratori do te kryeje te gjitha veprimet zyrtare te shoqerise.
2. Shoqeria, ne te ardhmen mund te administrohet edhe nga nje Administrator tjetër, i cili emerohet me Vendim te Ortakut/eve.
3. Administratori, mund t'i delegoje kompetencat e tij (pjeserisht ose te gjitha) me shkrim ne

formen e autorizimit ose me prokure.  
4.Vendimet e ortakeve, evidencohen ne nje rregjister te vecante.

#### **NENI 19**

##### **ASAMBLEJA**

Asambleja e Pergjithshme ka te drejte:

1. Te hartoje e miratoje ndryshimet ne statut.
  2. Te miratoje bilancin vjetor te shoqerise.
  3. Te vendose per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
  4. Te emeroje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise.
  5. Te shpalle prishjen, likujdimin dhe falimentimin e shoqerise.
- Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

#### **NENI 20**

##### **TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori ka keto te drejta.

1. Te mbikeqyre dhe te kontrolloj gjithë veprimtarine e shoqerise.
2. Te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet, ne administraten publike dhe organet gjyqesore.
3. Te emeroje personelin e domosdoshem.
4. Te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise.
5. Te therrase asamblene dhe te vendose rendin e dites.
6. Te hartoje planet e llogarive ekonomike dhe te paraqese ato per miratim asamblese se ortakeve.

#### **NENI 21**

Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te kryera gjate administrimit te shoqerise.

#### **NENI 22**

1. Shoqeria "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" sh.p.k., mund te emeroje ne vazhdimesi nje ekspert kontabel per nje afat kohor te percaktuar me te drejte rizzjedhje.
2. Emerimi kryhet nga ortaket.
3. Per kompetencat, shkarkimin dhe shperblimin etij zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

#### **NENI 23**

##### **MARREDHENIET E PUNESIMIT**

1. Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet ne baze te kontrates individuale te punes ose kolektive, ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin vendas ne kete fushe.
- 2.Marrja ne pune behet me ane te regjistrimit nga ana e punedhenesit ne librin e punes se shoqerise.
3. Largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori. Largimi nga puna lidhet me mbarimin e kontrtaes se punes, per shkak te shkeljes disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
- 4.Mos marreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise do te zgjidhen me mirekuptim, ose kur ky i fundit nuk eshte i mundur palet do ti drejtohen gjykates kompetente perkatese.

#### **NENI 24**

##### **BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQERISE**

- 1.Shoqeria tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" sh.p.k., me ane te bashkimit mund ti



kaloje trashëgimime e saj nje shoqërie ekzistuese ose nje shoqërie te re qe ato themelojne dhe qe ushtron te njejtin aktivitet.

2. Shoqëria tregtare "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANIŞMANLIK" sh.p.k., me ane te ndarjes mund ti kaloje trashëgimime e saj disa shoqërive te tjera ezistuese ose shoqërive te reja.

#### **NENI 25**

##### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISE.**

1. Shoqëria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfare do lloj shkak, si ne rast falimentimi, privimi te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket.

2. Shoqëria hyn ne fazen e e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj. Per kete, ortaket emerone nje ose me shume likujdator.

3. Shoqëria prishet ne keto raste:

- Kur nuk mund te permbushet objekti per te cilin eshte krijuar.
- me vullnetin e ortakeve.
- me vendim te gjykates.
- kur mbaron afati i veprimtarise se shoqërise.

#### **NENI 26**

##### **DISPOZITA TE FUNDIT**

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te aplikohet ligji "PER SHOQËRITE TREGTARE" si dhe legjislacioni ne fuqi.

#### **NENI 27**

Ky statut hyn ne fuqi ditën e regjistrimit te shoqërise ne regjistrin tregtarne qendren kombetare te regjistrimit(QKB).

#### **NENI 28**

Ky statut perpilohet ne 3 kopje origjinale me te njejtën vlere ligjore perktheu **Taulant Anamali** i njohur dhe pranuar nga ortaku.

Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin e shoqërise.

#### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**AYFER KORKMAZ**

AYFER KORKMAZ

28.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



DATE 01/11/2023  
NR REP 8645/2

*Noterja E. Demollari  
Yalova e Pulles  
11. Dega*

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 01.11.2023 (dymije e njezete e tre), vërtetoj nënshkrimin e ortakut të shoqërisë "KORKMAZ PSIKOLOJIK DANISMANLIK" Ayfer Korkmaz, shtetase Turke, lindur në Yalova dhe banues në Turqi, me adresë Turqi, lindur më 13/09/1971, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. U30297765 dhe nr. personal U30297765, i cili më ka deklaruar se akti është nënshkruar prej saj dhe unë Noteri/ja vërtetoj deklarin e saj dhe pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**  
MAJLINDA DEMOLLARI

*0961902890 mb  
11/11/2023  
11/11/2023  
523104*

